



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

**Procesi i përzgjedhjes së një përfaqësuesi të shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile**

Pas tërheqjes së një anëtari të shoqërisë civile nga Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) organizon procesin e përzgjedhjes së një përfaqësuesi të shoqërisë civile në Këshill. Një përfaqësues i shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile do të nominohet dhe zgjedhet nga vet organizatat e shoqërisë civile. Shoqëria civile përfaqësohet në Këshill me pesëmbëdhjetë (15) përfaqësues, nga të cilët një (1) është emëruar nga Platforma CiviKos ndërsa katërmëdhjetë (14) të tjerë janë zgjedhur nga vet organizatat e shoqërisë civile.

Procesi i përzgjedhjes do të synojë balancin në mes të:

- 1. Përfaqësimit** - duke u dhënë mundësinë OshC-ve që të nominojnë kandidatë/e nga radhët e tyre ose të OshC-ve tjera sektoriale si dhe duke inkurajuar nominimin e grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nën-përfaqësuar;
- 2. Ekspertizës** - duke përcaktuar kriteret minimale që duhet të plotësohen nga të nominuarit, si dhe nga OshC-të nominuese.

**Kriteri kryesor për të nominuarit** përcakton që: i nominuari duhet të ketë përvojë të dëshmuar pune në fushën e caktuar; dhe të jetë i angazhuar në një OshC për të paktën 3 vite të fundit është e profilizuar në sektorin e caktuar.

**Kriteri kryesor për nominuesit (OshCtë që bëjnë nominime)** përcakton që: OshC-ja të ekzistojë të paktën gjatë 3 viteve të fundit.

E gjithë procedura e nominimit dhe përzgjedhjes menaxhohet nga Sekretariati i Platformës CiviKos nëpërmjet Formularëve për Nominim dhe Formularëve për Votim, ku përcaktohen qartë të gjitha kushtet e kërkuara dhe dokumentet shtesë. Një panel verifikues i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një

përfaqësues i ZQM/ZKM konfirmojnë plotësimin e kriterëve të të nominuarëve, para zyrtarizimit të listës përfundimtare për votim. Të drejtë për të votuar për kandidatët e nominuar kanë të gjitha OshC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ.